



IOM International Organization for Migration
OIM Organisation Internationale pour les Migrations
OIM Organización Internacional para las Migraciones



Ngritja e kapaciteteve, Rritja e Shkallës së Informimit dhe Ndërgjegjësimit për Nxitjen e Emigracionit të Rregullt në Ballkanin Perëndimor Informacion mbi Projektin

Përmbledhje e Projektit

Ky Projekt synon të kontribuojë në përpjekjet e tanishme për nxitjen e migracionit të rregullt brenda për brenda dhe nga Ballkani Perëndimor. **Objektivi i Projektit është forcimi e kapaciteteve vendore në zhvillimin e politikave si dhe dhënien e shërbimeve të duhura dhe efikase të informimit, këshillimit dhe referencës për migrantët dhe emigrantët e mundshëm, duke parandaluar kështu emigracionin e parregullt e duke optimizuar mundësitë e tyre për migracion të rregullt.**

Shërbimet e informimit, këshillimit dhe referimit për migrantët dhe emigrantët e mundshëm do të realizohen nëpërmjet krijimit të rrjetit rajonal të Qendrave të Shërbimit për Migrantët (QSHM). QSHM-të do të presin çdo ditë vizitorë dhe do t'u japin atyre asistencë të individualizuar si dhe do të organizojnë, sipas rastit, seanca këshillimi në grup mbi realitetin dhe rreziqet e migracionit të parregullt dhe mundësitë/proçedurat për mundësi pune të denja në vend dhe/ose për migracion të rregullt. Do të prodhohen dhe do të shpërndahen edhe materiale të cilat do të përditësohen vazhdimisht me fakte dhe me të dhëna mbi mundësitë e migracionit të rregullt në Shtetet Anëtare të BE-së. QSHM-të do të kryejnë gjithashtu edhe shërbime refererimi tek institucionet përkatëse vendore lidhur me zhvillimin e aftësive individuale, në funksion të shtimit të mundësive të punësimit si brenda ashtu dhe jashtë vendit.

QSHM-të do të vendosen brenda strukturave të njohura vendore, si Drejtoritë Rajonale dhe Zyrat Vendore të Punësimit, dhe në Ministritë përkatëse. Njëkohësisht, zyrtarët e këtyre strukturave vendore do të bashkëpunojnë me stafin e IOM-it, duke marrë trajnim pa shkëputje nga puna, brenda kuadrit të veprimtarisë ditore të QSHM-së, gjatë gjithë periudhës së zbatimit të këtij Projekti. Kjo do të lejojë shkëputjen e plotë të IOM-it në fazën përfundimtare dhe dorëzimin e detyrave në institucionet përkatëse në përfundim të kohëzgjatjes së Projektit.

Veç dhënies së shërbimeve të drejtpërdrejta për migrantët dhe emigrantët e mundshëm, projekti do të përqëndrohet edhe **në ngritjen e kapaciteteve të autoriteteve lokale për zhvillimin e politikave dhe praktikave të mira si** vende dërguese dhe pritëse, në kontekstin e nevojave të tanishme dhe atyre që janë parashikuar për fuqi të huaj punëtore. Projekti parashikon transferimin e dijeve teknike dhe ekspertizës, si në nivel rajonal ashtu dhe në atë kombëtar. Së pari, IOM dhe ILO do të organizojnë një **Seminar Rajonal Trajnimi 3 ditor mbi Menaxhimin e Migracionit për Motive Punësimi** në Tiranë për politikëbërësit dhe menaxherët e migracionit, si shërbimet rajonale dhe kombëtare të punësimit, ministritë e punës dhe çështjeve sociale, inspektorët e punës, OJQ-të, organizatat e punëdhënësve dhe punëmarrësve në të gjitha vendet e përcaktuara dhe akademikë. Për këtë veprimtari, IOM dhe ILO do të sjellin ekspertë dhe burimet e tyre njerëzore, si dhe Manualin e botuar rishtaz mbi “Përcaktimin e Politikave Efektive të Emigracionit për Qëllime Punësimi në Vendet e Origjinës dhe Vendet e Destinacionit”. Ky seminar rajonal trajnues do të vijojë me një **Trajnim në nivel kombëtar, si dhe diskutime e tryeza të rrumbullakta dypalëshe.** Grupe

ekspertësh, të përbërë nga zyrtarë të IOM-it dhe BE-së do të vizitojnë secilin prej vendeve të përcaktuara për diskutime konkrete mbi atë vend, dhe do të organizojnë trajnim të posaçëm me zbatuesit e politikave për të përmirësuar politikat, ligjet dhe praktikat kombëtare (duke ngritur kapacitetet e zyrtarëve për të rregulluar dhe monitoruar veprimtarinë e Agjencive Private të Punësimit (APP) si dhe Shërbimeve Publike të Punësimit (SHPP) për të siguruar bashkëpunim ndërmjet tyre.

Rezultatet e profilizimit të përditshëm të migrantëve dhe emigrantëve të mundshëm, ndërmarrë nga ana e QSHM-ve do të përfshihen në **raportin e kërkimeve mbi migracionin e rregullt nga Ballkani Perëndimor**, i cili do të bëjë analizën e mundësive të emigracionit nga rajoni si dhe tendencave aktuale të migracionit, duke vënë në pah sfidat që kanë përpara këto qeveri dhe migrantët për optimizimin e përdorimit të rrugëve ligjore të migracionit dhe minimizimin e risqeve që vijnë nga lëvizjet e parregullta.

Vendet e zbatimit të Projektit

Shqipëria, Bosnia&Hercegovina, Kroacia, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Republika e Malit të Zi dhe Republika e Serbisë, duke përfshirë dhe Provincën e Kosovës.

Partnerët dhe Bashkëpunorët e Projektit:

- Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO)

Shqipëri:

- Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
- Shërbimi Kombëtar i Punësimit

Bosnje & Hercegovinë

- Ministria e Çështjeve Civile
- Ministria Federative e Punës dhe Politikës Sociale
- Ministria e Punës dhe Mirëqënies së Invalidëve të Luftës e Republikës Srpska

Kroaci

- Shërbimi Kroat i Punësimit

Ish -Republika Jugosllave e Maqedonisë

- Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale
- Agjensia e Punësimit
- OJQ “Organizacija na Zeni na Opstina Kriva Palanka”
- OJQ Multikultura

Mal i Zi

- Agjencia Shtetërore e Punësimit
- Ministria e Brëndshme

Serbi

- Ministria e Ekonomisë dhe Zhvillimit Rajonal
- Shërbimi Kombëtar i Punësimit
- OJF Grupa 484
- Instituti i Politikës dhe Ekonomisë Ndërkombëtare

Kosovë (Serbi)

- Departamenti i Punës dhe Punësimit, Ministria e Punës dhe Mirëqënies Sociale
- Ministria e Punëve të Brëndshme

Objektivat e Projektit:

- (i) Reduktimi i migracionit të parregullt drejt, brënda për brënda dhe nga Ballkani Perëndimor, duke përfshirë dhe atë drejt BE-së dhe Zvicrës;
- (ii) Zgjerimi i kapaciteteve kombëtare për menaxhimin e migracionit për qëllime punësimi në Ballkanin Perëndimor;
- (iii) Rritja e mirëkuptimit dhe shtimi i njohurive mbi prirjet dhe mundësitë migratore në Ballkanin Perëndimor si dhe mundësitë për migracion për qëllime punësimi për shtetasit e vendeve të Ballkanit Perëndimor;
- (iv) Forcimi i rrjetit të lidhjeve dhe i dialogut mbi migracionin për qëllime punësimi ndërmjet qeverive dhe aktorëve të tjerë përkatës në Ballkanin Perëndimor dhe vendeve të parapëlqyera të destinacionit, duke përfshirë Shtetet Anëtare të BE-së dhe Zvicrës.

Drejtimi i Projektit:

Ky Projekt do të drejtohet nga Zyra Rajonale e IOM-it në Budapest (Hungari), me mbështetjen e zyrave të IOM-it në vendet pjesëmarrëse dhe në bashkërendim me ekipin zbatues të ILO-s. Për më shumë informacion kontaktoni si më poshtë:

Magdalena Majkowska-Tomkin, Koordinatore Projektit (Budapest)

tel. +361 472 2519, e-mail: mmajkowska@iom.int

Miriam Neziri, Koordinatore Kombëtare e Projektit për Shqipërinë, mneziri@iom.int, + 355 42 578 36

Mirsada Zeco, Koordinatore Kombëtare e Projektit për Bosnje & Herzegovinën, mzeco@iom.int, + 387 33 567 212

Suna Skupnjak-Kapic, Koordinatore Kombëtare e Projektit për Kroacinë, sskupnjak@iom.int + 385 1 481 6885

Sonja Bozinovska, Koordinatore Kombëtare e Projektit për Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë sbozinovska@iomskopje.org.mk, + 389 2 30 88 100

Sheremet Kukaj, Koordinatore Kombëtare e Projektit për Provincën e Kosovës skukaj@iom.ipko.org, + 381 38 249 042

Dusica Zivkovic, Koordinatore Kombëtare e Projektit për Malin e Zi, dzivkovic@iom.int, + 382 68 107 777

Milena Milivojev, Koordinatore Kombëtare e Projektit për Serbinë, mmilivojev@iom.int, + 381 11 38 21 703

Ky Projekt ka përfutuar asistencë financiare nga Komisioni Evropian në kuadër të Programit AENEAS 2006, nga Zyra Federale Zvicerane për Migracionin si dhe nga Zyra Federale Gjermane për Migracionin dhe Refugjatët, Bashkëpunimi Italian për Zhvillim dhe Qeveria e Lihtenshtejn



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra



Federal Office
for Migration
and Refugees

